

**LIGJ**  
**Nr.7693, datë 6.4.1993**

**PER URBANISTIKEN**  
**(I shfuqizuar)**

**I azhurnuar me:**

- *Dekretin nr. 772, datë 14.2.1994*
- *Ligjin nr. 8015, datë 19.10.1995*
- *Ligjin nr. 8249, datë 7.10.1997*

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE**

**V E N D O S I :**

**KREU I**  
**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**Neni 1**

Urbanistika në kuptimin e këtij ligji, shpreh dhe përcakton rregullat e përgjithshme të vendosjes dhe arkitekturës së ndërtimeve në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përveç tokave bujqësore. Në përcaktimin e këtyre rregullave mbahen parasysh zhvillimi ekonomik e social i vendit, aktual e perspektiv, në nivel kombëtar e lokal, mbrojtja e vendit, mjedisit e natyrës, ruajtja dhe vënia në pah e vlerave urbanistike-arkitektonike, monumentale e arkeologjike.

**Neni 2**

Organet e pushtetit lokale janë administruese të territorit nën juridiksionin e tyre në përputhje me kompetencat e përcaktuara me ligj. Me qëllim që të përmirësohet skema jetësore, të administrohet toka me kursim, të sigurohet mbrojtja e mjedisit dhe të ruhet ekuilibri midis popullsisë që banon në zonat qytetare dhe fshatare, organet e pushtetit lokal harmonizojnë vendimet e tyre për përdorimin e tokës, duke respektuar reciprokisht autonominë e tyre.

**Neni 3**

Të gjitha ndërtimet bëhen në bazë të master planeve, planeve rregulluese të përgjithshme, studimeve urbanistike pjesore, planimetrive të shesheve të ndërtimit bashkë me kondicionet urbanistike dhe të lejes së ndërtimit.

Projektimi i të gjitha llojeve të ndërtimeve mbi e nëntokësore dhe infrastrukturës inxhinjrike në qytet e në fshat bëhet në bazë të normave e kushteve teknike në fuqi.

#### **Neni 4**

Master plani, plani rregullues i përgjithshëm, studimi urbanistik pjesor, vija kufizuese e ndërtimit dhe vija suburban janë dokumente teknike që kushtëzojnë të gjitha marrëdhëniet juridike në fushën e urbanistikës.

Përmbajtja dhe mënyrat e hartimit të tyre përcaktohen në Rregulloren e Urbanistikës, e cila miratohet nga Këshilli I Ministrave

#### **Neni 5**

Në mungesën e planit rregullues ose të një dokumenti urbanistik të njëvlershëm me të, lejohen jashtë zonave të urbanizuara:

1. Përshtatja, riparimi dhe zgjerimi i pjesshëm i ndërtimeve ekzistuese.
  2. Instalime të nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë bujqësore e blegtorale.
  3. Ngrehina të përkohëshme që bëhen për qëllime sezonale bujqësore, me prishjen e të cilave toka kthehet përsëri për përdorim bujqësor.
- Leja për këto ndërtime jepet nga organet e përcaktuara në këtë ligj.

## **KREU II KOMPETENCAT E ORGANEVE SHTETERORE NE FUSHEN E URBANISTIKES**

#### **Neni 6**

Organi më i lartë shtetëror për miratimin e studimeve urbanistike është Këshilli i Ministrave.

Këshilli i Ministrave miraton këto studime dhe ndryshimet e tyre:

- master planet e studimeve urbanistike që shtrihen në gjithë territorin e Republikës,
- studimet ndërrajonale,
- planet e përgjithshme rregulluese të qyteteve me mbi 10000 banorë, vijën kufizuese të ndërtimeve dhe kufijtë suburban të tyre.
- normat, rregullat dhe kushtet e projektimit urban.

Këto studime paraqiten për miratim nga Këshilli I Rregullimit të Territorit të Shqipërisë, pasi merret mendimi I organeve të pushtetit lokal, territoret administrative të të cilave preken nga këto studime.

#### **Neni 7**

Këshilli i Ministrave krijon me vendim të veçantë **Këshillin e Rregullimit të Territorit të Shqipërisë**, i cili miraton dhe ndryshon:

- studimet urbanistike rajonale,
- studimet pjesore urbanistike të rëndësishme për zhvillimin e turizmit, të parqeve kombëtare, zonave të aeroporteve, porteve, infrastrukturën e nivelit kombëtar etj.,
- sheshet e ndërtimit me sipërfaqe mbi 0.5 ha; për sheshe në toka bujqësore merret edhe miratimi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit,
- miraton në parim lejet e ndërtimit në sheshe mbi 0.5 ha mbi bazën e projektit teknik.
- planet rregulluese të qendrave të rretheve pavarësisht nga popullisa e tyre.

Këshilli i Rregullimit të Territorit të Shqipërisë ka të drejtë të reduktojë përmasat e sheshit të miratuar me projektide, në qoftë se projektzbatimi i paraqitur për leje ndërtimi nuk justifikon sipërfaqen e dhënë.

Këshilli i Rregullimit të Territorit të Shqipërisë me iniciativë të vet apo kur informohet nga organizmat qeveritare në nivel territorial e dikasterial, kur konstaton se ka patur shkelje të procedurave që pengojnë realizimin e programeve nacionale të zhvillimit, merr vendime të motivuara në lidhje me kompetencat e KRRT të rretheve. Për këto vendime KRRT e rretheve mund të bëjnë ankesë në KRRTSH dhe pas shqyrtimit të ankesës nga KRRTSH, vendimi i KRRTSH është i formës së prerë.

### **Neni 8**

Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit ushtron kontroll dhe ndjek veprimtarinë e rregullimit të territorit nëpërmjet Drejtorisë së Rregullimit të Territorit, e cila bashkërendon punën ndërmjet organeve shtetërore qendrore, organeve të urbanistikës në pushtetin lokal dhe Institutit të Studimeve e Projektive të Urbanistikës.

Organi i specializuar shtetëror në fushën e studimeve e projekteve urbane është Instituti i Studimeve dhe Projektive të Urbanistikës, detyrat e të cilit përcaktohen në Rregulloren e Urbanistikës.

### **Neni 9**

Organet e specializuara për problemet e urbanistikës në pushtetin lokal janë:

- Këshilli i rregullimit të territorit në rreth.
- Seksioni i urbanistikës në rreth.
- Zyrat e urbanistikës në bashki.
- Zyrat e urbanistikës në komunë.

### **Neni 10**

Këshilli i rregullimit të territorit në rreth funksionon si organ vendimor, nën drejtimin e kryetarit të këshillit të rrethit. Këshilli i rregullimit të territorit në rreth përbëhet nga 11-21

anëtarë, në varësi nga madhësia e rrethit. Mbi 50% e anëtarëve duhet të jenë urbanistë, arkitektë e inxhinierë ndërtimi. Pjesa tjetër përbëhet nga specialistë të fushave të tjera që lidhen me urbanistikën. Në këshillin e rregullimit të territorit në rreth duhet të marrin pjesë kryetarët e bashkive, specialistë të ruajtjes e mbrojtjes së mjedisit e të kadastrës bujqësore. Anëtarët, mënyra e zgjedhjes dhe e shpërblimit të tyre caktohen nga këshilli i rrethit.

### **Neni 11**

Këshilli i Rregullimit të Territorit në rreth miraton dhe ndryshon:

- Planin e përgjithshëm rregullues për rrethe me popullsi deri në 10 000 banorë, duke përjashtuar qendrat e rretheve, si dhe studimet pjesore urbanistike brenda rrethit, duke u mbështetur në një plan rregullues ose studim pjesor të miratuar.
- Detyrën e projektimit për planin rregullues të qyteteve dhe të zhvillimeve kryesore urbanistike në rreth.
- Sheshet e ndërtimit deri në 0.5 ha vetëm mbi bazën e një plani rregullues ose të një studimi pjesor të miratuar.
- Projektet teknike të objekteve në sheshe deri në 0.5 ha.
- Lejet e ndërtimit.
- Lejet për prishje objektesh.
- Lejet për prerje drurësh.
- Platformën për zhvillimin e konkurseve për studime urbane dhe shqyrton ofertat në formë konkurruese, në bazë të legjislacionit në fuqi.

Materialet që shqyrton KRRT-ja e rrethit, përgatiten dhe paraqiten për miratim nga sekretaria teknike e KRRT-së, funksionet e së cilës kryhen nga seksioni i urbanistikës në rreth. Materialet që sipas kompetencës duhet të kalojnë për miratim në KRRTSH, duhet të dorëzohen në sekretarinë e KRRTSH jo më vonë se një muaj pas miratimit të tyre në KRRT-në e rrethit.

### **Neni 12**

Këshilli i rregullimit të territorit mblidhet një herë në muaj dhe me kërkesën e kryetarit të këshillit edhe jashtë rradhe.

Mbledhja hapet me pjesmarrjen e 2/3 të anëtarëve. Vendimi I këshillit merret me shumicë votash, del me firmën e kryetarit të këshillit dhe është i formës së prerë.

Në këshillin e rregullimit të territorit marrin pjesë pa të drejtë vote përfaqësuesit e pushtetit lokal të interesuar dhe autoritetet e studimeve që shqyrtohen.

Këshilli i rrethit, për raste kur e gjykon të domosdoshme, ka të drejtë të kërkojë të njihet dhe të kthejë për shqyrtim studimet dhe vendimet e miratuara nga KRRT e rrethit. Në rast se KRRT-ja e rrethit nuk e ndryshon vendimin, vendimi i këshillit të rrethit mbetet në fuqi.

### **Neni 13**

Seksioni i urbanistikës në rreth ka këto të drejta e detyra:

- përgatit materialet mbi drejtimit e rregullimit dhe zhvillimit urbanistik të rrethit dhe ia paraqit këshillit të rregullimit të territorit, i cili pasi i shqyrton ia paraqet për miratim këshillit të rrethit;

-harton studime urbanistike ose i porosit ato në organizmat projektues shtetërorë të përcaktuara në ligj ose organizma privatë, pasi të kenë marrë autorizim në KRRT sipas kompetencës, në zbërthim të studimeve urbanistike të përgjithshme e pjesore të miratuara;

- paraqet në këshillin e rrethit kërkesat për sheshe ndërtimi, i cili miraton shpërndarjen e tyre, paraqet në KRRT kërkesat për leje ndërtimi, leje prishje objektesh, leje prerje drurësh që janë kompetencë e këtij këshilli;

- harton studimet urbanistike për komunat;

- kontrollon nëse ndërtimet që u është dhënë leje përdoren sipas destinacionit;

- kur vëren shkelje të këtij ligji, zbaton sanksionet e parashikuara në këtë ligj;

- mban kadastrën dhe statistikën urbane, bën azhurnimin e planimetrisë së qytetit dhe e arshivon atë në çdo fund viti;

- bën vlerësimin e truallit që jepet për ndërtim sipas dispozitave në fuqi;

- mban aktet e kontrollit për fazat e zbatimit të punimeve dhe arshivon dokumentacionin teknik të objekteve;

- propozon norma e kondicione specifike të urbanistikës për rrethin përkatës, të cilat miratohen nga organet e parashikuara në këtë ligj;

- kur paraqiten kushte të reja, për studimet e miratuara nga instanca shtetërore më të larta, me miratimin e këshillit të rregullimit të territorit të rrethit, përgatit materialin për ndryshimet përkatëse;

- mban lidhje sistematike me zyrat e urbanistikës në bashki e komunë;

- për çdo material që i paraqit këshillit të rregullimit të territorit të rrethit jep me shkrim mendimin e tij.

Përgjegjësi i seksionit të urbanistikës në rreth miratohet nga ministri i Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, me propozim të këshillit të rrethit.

#### **Neni 14**

Organet që veprojnë në fushën e urbanistikës në Bashkinë e Tiranës kanë të njëjtat të drejta e detyra që përcaktohen për organet e urbanistikës në rreth dhe në bashki.

#### **Neni 15**

Zyra e urbanistikës në bashki ka këto të drejta e detyra:

- përgatit materialet e programit të zhvillimit urbanistik të qytetit dhe dokumentacionin e planit rregullues për territorin nën juridiksionin e vet;

- porosit hartimin e planit rregullues të qytetit;

-harton ose porosit studime pjesore urbanistike në organet projektuese të specializuara shtetërore. Projektuesit privatë, të pajisur me licencën përkatëse, lejohen të kryejnë studime

urbanistike vetëm pasi të kenë marrë autorizim nga Këshilli i Rregullimit të Territorit në rreth, organ që miraton studimin sipas kompetencës;

- kur vëren shkelje të këtij ligji, zbaton sanksionet e parashikuara në këtë ligj;  
- shqyrton kërkesat për shesh ndërtimi për banesa e lokale private tregtie apo shërbimesh dhe dokumentacionin përkatës, vetëm kur ka plan rregullues të përgjithshëm ose studim pjesor urbanistik të miratuar, dhe pasi jep mendimin e tij ia paraqet për miratim këshillit të bashkisë;

- paraqet në këshillin e rregullimit të territorit të rrethit kërkesat për leje ndërtimi, prishje objektesh, prerje drurësh; paraqet në seksionin e urbanistikës në rreth kërkesat për sheshe ndërtimi që nuk janë kompetencë e këshillit të bashkisë; jep kondicionet urbanistike për trojet në pronësi private, sipas studimeve të miratuara

Numri i punonjësve të zyrës së urbanistikës caktohet nga këshilli i bashkisë, gjithnjë brenda profilit: urbanist, arkitekt, inxhinier ndërtimi e inxhinier topograf.

### **Neni 16**

Zyra e urbanistikës në komunë ka këto të drejta e detyra:

- ndjek programet e zhvillimit urbanistik të miratuara nga këshilli i komunës brenda territorit të komunës;

- kur vëren shkelje të këtij ligji, zbaton sanksionet e parashikuara në këtë ligj;

- jep leje për ndërtimet e përmendura në nenin 5 të këtij ligji;

- shqyrton kërkesat për shesh ndërtimi për banesa vetjake dhe lokale private tregtie apo shërbimesh dhe dokumentacionin përkatës, vetëm kur ka plan rregullues të përgjithshëm dhe studim pjesor urbanistik të miratuar, dhe pasi jep mendimin e tij ia paraqet për miratim këshillit të komunës;

- paraqet për miratim në këshillin e rregullimit të territorit të rrethit kërkesat për leje ndërtimi, leje për prishje objektesh dhe prerje drurësh; paraqet në seksionin e urbanistikës në rreth kërkesat për sheshe ndërtimi që nuk janë kompetencë e këshillit të komunës.

Numri i punonjësve të zyrës së urbanistikës caktohet nga këshilli i komunës brenda profilit: urbanist, arkitekt, inxhinier ndërtimi ose inxhinier topograf. Në mungesë të tyre emërohen teknikë ndërtimi ose teknikë topografë.

## **KREU III**

### **ADMINISTRIMI I TOKES PËR NDERTIME**

### **Neni 17**

Personave fizikë e juridikë vendas, për urbanizimin e hapësirës në territoret brenda juridiksionit të rretheve, bashkive e komunave, u jepet për ndërtim truall në pronësi nëpërmjet shitjes, sipas dispozitave përkatëse.

Personave fizikë e juridikë të huaj u jepet truall për ndërtim me qira ose u shitet sipas dispozitave përkatëse.

### **Neni 18**

Vendet e grumbullimit të mbeturinave e mbetjeve teknologjike miratohen bashkë me lejen e ndërtimit, pasi është marrë miratimi i organeve të ruajtjes dhe mbrojtjes e mjedisit. Për shkelje të dispozitave të këtij neni zbatohen sanksionet e parashikuara në këtë ligj.

### **Neni 19**

Administrimi i tokës për ndërtime bëhet nëpërmjet master planeve, planeve rregulluese të përgjithshme dhe studimeve pjesore urbanistike. Përmbajta e tyre përcaktohet në Rregulloren e Urbanistikës.

### **Neni 20**

Planet rregullues të përgjithshëm dhe studimet pjesore urbanistike të hartuara nga organet e përcaktuara në këtë ligj, depo zihen brenda 15 ditëve nga data e përfundimit të tyre në sekretarinë e këshillit të rrethit përkatës dhe për 30 ditë vihen në dispozicion të të interesuarve. Njoftimi bëhet me mjete të informacionit publik. Të interesuarit për këto materialenparaqesin vërejtjet e tyre dhe seksioni i urbanistikës bashkë me përfaqësuesit e organizatës projektuese motivon pranimin ose jo të vërejtjeve të paraqitura. Brenda 30 ditëve, vërejtjet pasqyrohen në material dhe po nëpërmjet seksionit të urbanistikës dhe përfaqësuesve të organizatës projektuese plani rregullues I përgjithshëm dhe studimet pjesore urbanistike paraqiten për miratim në këshillin e rregullimit të territorit në rreth.

### **Neni 21**

Planet rregullues të përgjithshëm dhe studimet pjesore urbanistike hartohen për periudha kohe të caktuara. Ato mund të ndryshohen me propozimin e organeve të pushtetit lokal, vetëm nga organet që kanë në kompetencë miratimin e tyre. Gjatë kohës që përgatitet ndryshimi i planit rregullues të përgjithshëm dhe studimit pjesor urbanistik mbeten në fuqi plani rregullues dhe studimi pjesor fillestar, deri në hartimin e ndryshimit dhe miratimin e tij.

### **Neni 22**

Paraqitja e kërkesës me shkrim për marrjen e sheshit të ndërtimit nga shteti është e detyrueshme për çdo person fizik a juridik, vendas a të huaj, që do të ndërtojë një structure ndërtimore mbitokësore ose nëntokësore.

Kërkesa për shesh ndërtimi bëhet sipas formularit nr.1 që I bashkëngjitet këtij ligji.

Me kërkesën për shesh ndërtimi të bashkëlidhet plani I vendosjes dhe projektideja e objektit që ndërtohet, si dhe infrastruktura përkatëse.

### **Neni 23**

Kërkesa për shesh ndërtimi paraqitet në zyrën e urbanistikës në bashki ose komunë, në varësi të vendndodhjes së sheshit. Vetëm në rastet kur ka plan rregullues ose studim pjesor të miratuar sipas kompetencave, zyrat e urbanistikës në bashki ose komunë, pasi japin mendimin e tyre, ia kalojnë kërkesat për sheshndërtimi për miratim këshillit të bashkisë ose komunës vetëm për ndërtimin e banesave e lokaleve të tregtisë e shërbimeve. Për të gjitha rastet e tjera ia kalojnë për miratim këshillit të rrethit.

Kur kërkesa për shesh ndërtimi ka nevojë për studim urbanistik vetë kërkuesi porosit studimin urbanistik në organet projektuese shtetërore ose private, me të cilat lidhet kontratë për hartimin e studimit.

### **Neni 24**

Destinacioni i shesheve kryesore të ndërtimit përcaktohet në planet e përgjithshme rregulluese ose në studimet pjesore urbanistike të miratuara. Për një shesh ndërtimi mund të paraqiten disa kërkesa.

**Këshilli i rrethit**, këshilli i bashkisë e komunës, sipas kompetencave të parashikuara në këtë ligj, i shqyrtojnë kërkesat në formë ofertash konkurruese, duke zgjedhur atë që plotëson më mirë kondicionet financiare, urbanistike, arkitektonike, funksionale, ekologjike etj.

### **Neni 25**

Organet e pushtetit lokal kur janë të interesuara për ndërtime në një zonë të caktuar, për objekte me rëndësi publike e shoqërore, si banesa, hotele, supermerkato, qendra tregtie etj., mund të shpallin konkurs. Shqyrtimi dhe zgjedhja e ofertave bëhen si në nenin 24.

### **Neni 26**

Këshilli i rregullimit të territorit në rreth është i detyruar të vërë në dispozicion të Entit Kombëtar të Banesave, sheshet e ndërtimit për ndërtim banesash sipas kërkesës së tij, për një afat prej 4 vjet.

### **Neni 27**

Nga data e paraqitjes së kërkesës për shesh ndërtimi deri në daljen e vendimit, për të gjitha rastet nuk duhet të kalojnë më shumë se 45 ditë. Zyrat e urbanistikës në rreth, bashki ose komunë bëjnë afishimin publik të studimit të miratuar dhe kërkesave për sheshe ndërtimi sipas vendndodhjes së tyre. Afishimi mbahet jo më pak se 20 ditë para shqyrtimit të tyre në këshillin e rrethit, bashkisë ose komunës. Për sheshet e ndërtimit që ka në kompetencë këshilli i rrethit, bashkisë ose komunës pasi shqyrton kërkesat, dokumentacionin dhe mendimin e zyrës së urbanistikës, vendos me shumicë votash dhënien e sheshit ofertës më të mirë. Vendimi i këtyre këshillave shpallet nga kryetari i rrethit, bashkisë ose komunës, i cili kur nuk është dakord ka të drejtë ta kthejë vendimin për rishqyrtim vetëm një here.



Vendimi për dhënie e sheshit bëhet sipas Formularit nr.2, pjesë e këtij ligji, ku përcaktohen saktë kondicionet urbanistike mbi bazën e të cilave do të projektohet objekti. Përgjigjja për kërkesën e sheshit të ndërtimit merret në organet ku ajo është paraqitur.

### **Neni 28**

Çdo person fizik e juridik, vendas apo i huaj që do të ndërtojë duhet të pajiset me leje ndërtimi, e cila është dokumenti ligjor që lejon piketimin e objektit. Piketimi bëhet nga zyra e urbanistikës në bashki e komunë ose nga persona të autorizuar prej tyre.

### **Neni 29**

Në rastin kur sheshet janë pronë shtetërore duhet të respektohen afatet si me poshtë:  
Nga data e marrjes së sheshit të ndërtimit deri në paraqitjen e kërkesës për leje ndërtimi, për sheshe me sipërfaqe deri 0.1 ha nuk duhet të kalojnë më shumë se 3 muaj dhe për sheshe me sipërfaqe mbi 0.1 ha jo më shumë se 6 muaj.  
Në rastin e shkëljes së këtyre afateve, zyra apo seksioni I urbanistikës vë në dijeni këshillin përkatës, i cili mund të vendosë për shtyrjen e afatit, ose për të bërë një shpërndarje të re të sheshit

### **Neni 29/a**

Rregullat e përcaktuara në nenin 29 të zbatohen edhe për të gjitha sheshet e ndërtimit të dhëna nga organet e pushtetit local që nga data 1.1.1990. Personave fizikë e juridikë që kanë kryer veprimet e blerjes e të regjistrimit në hipotekë e kadastër të këtyre shesheve, kur vendimet e miratimit të tyre bëhen të pavlefshme do t'u kthehet shuma e paguar për sheshin, e indeksuar me indeksin e çmimeve të konsumit.

### **Neni 30**

Leja e ndërtimit kërkohet kur kryhen këto punime:

- a) Ndërtime të reja të çdo lloji mbi e nëntokësore, si ndërtesa të çdo lloji, impiante, rrugë, ura, porte, aeroporte, autostrada, hekurudha, punime infrastrukture, ujësjellës, kanalizime, telefoni, elektrik, avull, varrezat, karriera etj.
- b) ndërtime mbi themele ekzistuese;
- c) ndryshime të objektit, që prekin anën e jashtme të tij në elementë arkitektonikë;
- d) hapje ose mbyllje dritarësh, shtime të vëllimit të objektit ekzistues në formë shtesash anësore ose ngritje të kateve shtesë;
- e) ndërtime provizore ose të përkohëshme;
- f) rrethime të përkohëshme, rrethime që prishin pamjen e rrugës, që pengojnë ose rrezikojnë qarkullimin;
- g) ndërtime barrakash, kioskash, ekspozitash, tribunash, ngritje kantieri, vendosje reklamash tregëtare etj.

### **Neni 31**

Kërkesa për leje ndërtimi bëhet sipas formularit nr.3, që i bashkëngjitet këtij ligji, dhe paraqitet për miratim bashkë me:

- vendimin për dhënien e sheshit të ndërtimit të miratuar nga këshilli i rregullimit të territorit, këshilli i bashkisë apo komunës,
- dokumentacionin për azhurnimin e rrjetit inxhinierik nëntokësor, ujësjellës, kanalizime, elektrik e telefoni, si dhe miratimin nga instancat përkatëse për lidhjen e tyre me objektin e ri,
- projektin teknik të objektit të hartuar nga një organizatë projektimi që e ka këtë të drejtë ose nga projektues privatë që kanë marrë licencë projektimi nga organi i përcaktuar nga Këshilli i Ministrave.

Të gjitha këto materiale përgatiten nga i interesuari dhe së bashku me kërkesën për leje ndërtimi paraqiten në zyrën e urbanistikës të pushtetit lokal, ku është kërkuar sheshi, e cila pasi shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e nevojshëm, jep mendimin e saj dhe ia përcjell këshillit të rregullimit të territorit në rreth.

- për objekte industriale ose me teknologji të paraqitet edhe licenca e shfrytëzimit, e lëshuar nga organi që e ka në kompetencë;
- për varrezat të paraqitet edhe miratimi i ndërmarrjes hidrogeologjike dhe i inspektorit të shëndetësisë në rreth

### **Neni 32**

Këshilli i rregullimit të territorit me shumicë votash miraton ose jo dhënien e lejes. Vendimi për dhënien e lejes së ndërtimit del me firmën e kryetarit të këshillit të rrethi dhe është i formës së prerë. Nga data e paraqitjes së kërkesës për leje ndërtimi në zyrën e urbanistikës deri në marrjen e vendimit nuk duhet të kalojnë më shumë se 30 ditë.

**KRRT-ja në rreth ka të drejtë të reduktojë përmasat e sheshit të ndërtimit në rastet kur projekti teknik i paraqitur për leje ndërtimi nuk justifikon sipërfaqen e dhënë me sheshin e ndërtimit, KRRT-ja e rrethit nuk mund të japë leje ndërtimi në asnjë rast kur projekti i paraqitur ka ndryshuar destinacionin e sheshit të ndërtimit. Kjo procedurë vlen për truall në pronësi shtetërore.**

### **Neni 33**

Leja e ndërtimit është e vlefshme për 6 muaj. Kur objekti që i jepet leje kërkon një kohë zbatimi më të gjatë se 6 muaj, leja e ndërtimit **jepet** për aq kohë sa kërkon ndërtimi i objektit.

Për shkelje të dispozitave të këtij neni zbatohen sanksionet e parashikuara në këtë ligj.

### **Neni 34**

Leja e ndërtimit, hartuar sipas formularit nr.4, që I bashkëngjitet këtij ligji, i lëshohet personit fizik e juridik të pajisur me liçensë për zbatim punimesh ndërtimore, pasi është bërë kontrata midis tij dhe personit fizik e juridik të interesuar (investitorit)

Seksioni i urbanistikës në rreth plotëson formularin nr.4 të lejes së ndërtimit për objektet që ndërtohen në sheshe me sipërfaqe mbi 0,5 ha, pasi të jetë marrë miratimi nga KRRT i Shqipërisë.

Për objektet që prokurohen me fonde shtetërore, lejen e ndërtimit e siguron organi që miraton fondin, përpara se të japë në sipërmarrja ndërtimin e objektit.

### **Neni 35**

Në lejën e ndërtimit në varësi të llojit të objektit përcaktohen edhe fazat e kontrollit të realizimit ndërtimor.

1. Piketimi i objektit.
2. Përfundimi i themeleve.
3. Përfundimi i karabinasë.

Kalimi nga një fazë në një tjetër bëhet vetëm pas përpilimit të akt-kontrollit nga organet e përcaktuara në këtë ligj.

### **Neni 36**

Shitja e truallit pronë shtetërore bëhet konform ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 "Për shitjen e trojeve". Vlefta e truallit përcaktohet sipas ofertës dhe kërkesës, duke zbatuar ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 "Mbi prokurimin publik" dhe vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave.

Veprimet financiare për blerjen e truallit mund të kryhen nëpërmjet seksionit të financës në rreth.

Personi fizik a juridik që bën ndërtime, detyrohet të paguajë jo më pak se 40 për qind të vleftës së truallit në momentin e marrjes së lejes për shesh ndërtimi.

Aktkontrolli për fillimin e punimeve detyron personin fizik a juridik që bën ndërtime, të ketë plotësuar pagesë totale jo më pak se 70 për qind të vlerës së truallit.

Leja e shfrytëzimit detyron personin fizik a juridik që bën ndërtime, të paguajë jo më shumë se vleftën e mbetur (30 për qind) nga vlefta totale e truallit dhe jep të drejtën e nënshkrimit të kontratës së shitjes së truallit.

Personi fizik a juridik që ndërton, si rregull duhet të dorëzojë pranë grupit të zbatimit të projektit dokumentacionin teknik të punimeve të kryera në çdo fazë të ndërtimit të objektit deri në momentin e marrjes së lejes së banimit ose shfrytëzimit nga seksioni i urbanistikës.

Personat privatë bëjnë pagesat reciproke për truallin, sipas marrëveshjes në mes tyre.

Kur blerësi i truallit është i huaj kalimi në pronësi të tij (hipotekimi) bëhet mbi bazën e një autorizimi të lëshuar nga organi i urbanistikës, që mbulon territorin ku kryhet ndërtimi, ku vërtetohet se investimi i realizuar ka arritur një vlerë sa trefishi i çmimit minimal të truallit, pronë shtetërore, të përcaktuar me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

### **Neni 37**

Në ngritjen e kantierit personi fizik a juridik që zbaton punimet është i detyruar të ekspozojë në një vend të dukshëm tabelën me të dhënat për llojin e objektit, emrin e firmës zbatuese, përgjegjësin e zbatimit të punimeve, emrin e organizatës projektuese dhe afatin e mbarimit të punimeve.

### **Neni 38**

Leja e ndërtimit që jepet për rrethimet e përkohëshme duhet të përcaktojë kufirin e rrethimit, lartësinë dhe llojin e rrethimit, duke mos penguar pamjen për qarkullimin rrugor dhe anën estetike.

Organizata ndërtuese detyrohet të mbajë pastër rrugët dhe territorin rreth objektit në ndërtim dhe me përfundimin e punimeve duhet të kthejë në gjendjen e mëparshme rrugët dhe trotuaret e dëmtuara.

Për shkelje të dispozitave të këtij neni, zbatohen sanksionet e parashikuara në këtë ligji.

### **Neni 39**

Leja për ndërtimin e objekteve të përkohshme jepet për 1 vit, sipas formularit nr.5, që i bashkëngjitet këtij ligji. Me mbarimin e këtij afati leja mund të përsëritet ose të anulohet nga organi që e ka lëshuar, kur krijohet një situatë e re urbanistike.

Përcaktimi teknik i ndërtimeve të përkohëshme jepet në Rregulloren e Urbanistikës.

### **Neni 40**

Objektet që paraqesin rrezik shembje me pasoja për banorët ose për të tjerët, të cilat nuk riparohen nga pronari Brenda afatit maksimal të qëndrueshmërisë fizike të tyre, në bazë të raporteve teknike të ekspertëve, me vendim të këshillit të rregullimit të territorit, shemben në afatin që caktohet në vendim, nga vetë pronari.

Me kalimin e afatit shemben nga organi që cakton këshilli I rregullimit të territorit në rreth. Shpenzimet paguhen nga pronari. Urdhri i firmosur nga kryetari i këshillit të rregullimit të territorit të rrethit për nxjerrjen e shpenzimeve është titull ekzekutiv.

### **Neni 41**

**Zyra e urbanistikës në bashki, në njësitë administrative të qytetit e komunës, kontrollon destinacionin e përdorimit të ndërtimeve, me qëllim që ai të jetë në përputhje me normativat dhe destinacionin urbanistik të tyre.**

Për ndryshim të destinacionit të ndërtesave në përgjithësi, si dhe për rastet kur kalimi i ndërtesave private nga një pronar tek tjetri bëhet me ndryshim destinacioni, merret leje në zyrën eurbanistikës në bashki ose komunë.

Për shkelje të dispozitave të këtij neni, zbatohen sanksionet e parashikuara në këtë ligj.

Këshillat e Rregullimit të Territorit në rrethe, Këshilli i Rregullimit të Territorit i Bashkisë së Tiranës dhe Këshilli I Rregullimit të Territorit të Republikës nuk miratojnë asnjë ndërtim të përhershëm ose të përkohshëm jashtë funksionit, në territore publike të tilla si:

- terrene shoqërore;
- terrene të gjelbërta;
- terrene sportive;
- rrugë, sheshe, vendqendrim; të përcaktuara dhe interpretuara në "Rregulloren e Urbanistikës" në pikat 103 deri në 106.

#### **Neni 42**

Në planet rregulluese të përgjithshme dhe studimet pjesore urbanistike, në bashkëpunim me Komitetin e Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Pyjeve bëhet klasifikimi i zonave pyjore, pyjeve, parqeve, brezave të gjelbër e territoreve të gjelbëruara që duhen ruajtur, mbrojtur e krijuar. Ky klasifikim ndalon çdo lloj ndryshimi, dëmtimi, zënie sheshi e ndryshim destinacioni që komprometon mbrojtjen, ruajtjen apo krijimin e këtyre zonave.

Për shkelje të dispozitave të këtij neni, zbatohensanksionet e parashikuara në këtë ligj.

#### **Neni 43**

Kërkesa për të bërë prerje apo shkulje drurësh në zona urbane të paparashikuara në studimet e aprovuara, bëhet nga pronari i tyre ose personi fizik a juridik i interesuar.

Kërkesa bëhet sipas formularit nr.6, që i bashkëngjitet këtij ligji.

#### **Neni 44**

Kërkesa për prerje apo shkulje drurësh i drejtohet zyrave të urbanistikës në bashki e komunë dhe miratohet nga këshilli I rregullimit të territorit.

Pas miratimit të kërkesës kërkuesit i lëshohet një leje, e cila është e vlefshme për një vit nga data e lëshimit. Leja jepet sipas formularit nr.7, që i bashkëngjitet këtij ligji.

#### **Neni 45**

Personi fizik a juridik, që pajiset me leje për prerje apo shkulje drurësh, është i detyruar që me mbarimin e punimeve të ndërtimit të bëjë sistemimin e territorit përreth sipas një projekt sistemim-gjelbërimi, realizimi i të cilit duhet të bëhet brenda 1 viti.

#### **Neni 46**

Kërkesa për leje për prishje ndërtesash ekzistuese bëhet nga pronari, sipas formularit nr.8, që i bashkëngjitet këtij ligji.

#### **Neni 47**

Në rast se me prishjen e ndërtesës ose ndërtesave krijohen probleme strehimi për banorët ekzistues, bashkë me kërkesën duhet të paraqitet edhe garancia për ristrehimin e tyre, me adresat, sipërfaqen e banimit, kushtet etj.

#### **Neni 48**

Kërkesa për prishjen e ndërtesës bashkë me dosjen përkatëse paraqitet në zyrën e urbanistikës në bashki a komunë. Procedura e miratimit është e njëjtë me atë të lejes së ndërtimit.

Nga paraqitja e kërkesës deri në daljen e vendimit nuk duhet të kalojnë më shumë se 30 ditë. Leja për prishje ndërtesash jepet sipas Formularit nr.9, që i bashkëngjitet këtij ligji. Për shkelje të dispozitave të këtij neni, zbatohen sanksionet e parashikuara në këtë ligj.

#### **Neni 49**

Për të ekzekutuar zbatimin e master planeve, planeve rregulluese të përgjithshme dhe studimeve pjesore urbanistike për ndërtimin e objekteve ekonomike e socialkulturore me rëndësi shtetërore e shoqërore (publike), pasuria e paluajtshme, pronë e personave fizikë a juridikë, mund të shpronësohet sipas rregullave të përcaktuar me ligj të veçantë.

### **KREU IV**

#### **NDERTIMET NE ZONAT TURISTIKE E TE PUSHIMIT**

#### **Neni 50**

Zonat turistike të cilësuara të tilla me ligj të veçantë, janë nën mbrojtje të shtetit. Kriteret e shfrytëzimit të këtyre zonave përcaktohen në master planet e zhvillimit urbanistik të tyre, planet rregulluese të përgjithshme dhe studimet pjesore urbanistike.

#### **Neni 51**

Me qëllim që të mbrohen zonat turistike:

- a) ndalohet marrja e materialeve tokësore si : dhe, zhavorr, rërë, gurë etj. përveç territoreve të këtyre zonave që janë përcaktuar si karriera;
- b) ndalohet marrja e materialeve nga zonat ujore kombëtare, përveç se me autorizimin përkatës nga këshilli I rregullimit të territorit të rrethit, ku të merret parasysh ndikimi i tyre në mjedisin përkatës;
- c) ndalohet kryerja e punimeve të tharjes, bonifikimit, krijimi i dambave etj., pa autorizimin e organeve që miratojnë studimin urbanistik.

Ky rregullim vlen edhe për punimet e mbrojtjes bregdetare që kryhen nga Ministria e Mbrojtjes.

#### **Neni 52**

Qytetet, fshatrat dhe qendrat e tjera të banuara që ndodhen brenda zonave turistike zhvillohen mbi bazën e planeve rregulluese të tyre. Bashkekzistenca e tyre dhe e sistemeve ekologjike natyrore zgjidhet nëpërmjet studimeve të master planit.

#### **Neni 53**

Krijimi dhe zgjerimi i porteve tregtare, turistike dhe të peshkimit, si dhe zonave industriale e tregtare në zonat turistike përkatëse, bëhen mbi bazën e master planeve të zhvillimit të zonave turistike.

#### **Neni 54**

Sheshet e ndërtimit për objekte turistike ose jo në zonat me përparësi për zhvillimin e turizmit, si dhe zonat urbane të përcaktuara si të tilla nga studimet urbanistike, miratohen sipas kompetencës që përcakton ky ligj.

Studimet dhe sheshet e miratuara i vihen në dispozicion Komitetit për Zhvillimin e Turizmit për zgjedhjen e ofertës konkurruese.

Dispozitat e ligjit nr.7665, datë 21.1.1995 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmi", që bien në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen

### **KREU V**

#### **ADMINISTRIMI I ZONAVE DHE TERRITOREVE ME VLERA TE VEÇANTA**

#### **Neni 55**

Ndërhyrja me master plane, plane rregulluese të përgjithshme dhe studime pjesore urbanistike në zonat ushtarake e strategjike bëhet me miratimin e Ministrisë së Mbrojtjes.

#### **Neni 56**

Në hartimin e master planeve të zhvillimit territorial të përcaktohen territoret me vlera ambientale, sistemet ekologjike, parqet kombëtare, rezervatet e florës e faunës, sipas klasifikimit dhe kriterëve për mbrojtjen dhe zhvillimin e tyre të parashikuar në dispozita të veçanta.

#### **Neni 57**

Zonat, komplekset dhe objektet ndërtimore arkeologjike e muzeale duhet të respektohen në studimet e zhvillimit urbanistik, duke siguruar mbrojtjen e tyre, sipas kërkesave të institucioneve të specializuara.

Ndalohet çdo lloj ndërtimi deri në distancën 200 m nga kufiri i zonave arkeologjike të vëna në mbrojtje. Ndërtime në qytetet muze, zonat muzeale, monumentet e veçanta dhe zonat rreth tyre, bëhen me lejen e institucionit përkatës.

#### **Neni 58**

Mbrojtja e strukturave dhe objekteve urbanistike- arkitektonike me vlera të veçanta, bëhet nga Këshilli I Rregullimit të Territorit të Shqipërisë.

## **KREU VI SANKSIONE**

### **Neni 59**

Shkelja e dispozitave të këtij ligji parashikuar në nenin 18 dënohet me gjobë deri në 10000 lekë dhe me pezullim të ndërtimit të objektit. Në rast përsëritje, anulohet leja e ndërtimit nga organi që e ka lëshuar.

### **Neni 60**

Në rastet kur objekti nuk ka filluar punimet brenda 3 muajve nga koha e dhënies së lejes së ndërtimit sipas neneve 28 dhe 33, dënohet me gjobë deri 10 000 lekë dhe me anulimin e lejes së ndërtimit. Në rast përsëritjeje anulohet vendimi i dhënies së sheshit nga organi që e ka lëshuar duke rikthyer 90 për qind të pagesës së depozituar për objektin.

### **Neni 61**

Shkelja e dispozitave të këtij ligji parashikuar në nenin 38 dhe 41, dënohen me gjobë deri 5000 lekë.

### **Neni 62**

Shkelja e dispozitave të këtij ligji parashikuar në nenin 42, si dhe prerja apo shkulja e drurëve pa leje, kur nuk përbën vepër penale dhe kur vlera e dëmit nuk i kalon të 5000 lekët, në varësi të shkallës së dëmit dënohet me gjobë deri 10000 lekë.

Kundravajtësi detyrohet të paguajë edhe vlerën e dëmit të shkaktuar.

Kur vlera e dëmit të shkaktuar nga çdo person është më e madhe se 5000 lekë, personi fajtor përgjigjet sipas dispozitave të Kodit Penal.

### **Neni 63**

Ndërtimet që janë bërë apo do të bëhen pa leje ndërtimi në sheshin e miratuar, janë ndërtime të kundraligjshme. Seksioni I urbanistikës në rreth, ose zyrat e urbanistikës në bashki a komunë i pezullojnë menjëherë ndërtimet pa leje. Këto organe së bashku me organet e rendit publik mbajnë procesverbalet e konstatimit dhe pezullimit të ndërtimit të kundraligjshëm dhe japin gjobë deri 50000 lekë.

Seksioni i urbanistikës, zyra e urbanistikës në bashki a komunë i paraqet materialin këshillit të rregullimit të territorit në rreth, i cili vendos shembjen e objektit dhe kthimin e terrenit në gjendjen e mëparshme. Shembja kryhet nga kundravajtësi, në të kundërt caktohet një organizëm nga këshilli i rregullimit të territorit, i cili bën shembjen me shpenzimet e kundravajtësit.



#### **Neni 64**

Zënia arbitrare e truallit për ndërtim, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë deri 100000 lekë, me prishjen e objektit dhe kthimin e truallit në gjendjen e mëparshme me shpenzimet e kundravajtësit.

Në rastet e zënies së paligjshme të truallit, personi juridik a fizik i interesuar, njofton në rajonin më të afërt të policisë, i cili brenda 24 orëve është i detyruar të pezullojë zënien e truallit.

Lirimi i truallit dhe prishja e objektit bëhet me urdhër administrativ të kryetarit të bashkisë ose komunës, ose të personave që ushtrojnë këto funksione në atë moment, sipas informimit me shkrim nga zyra e urbanistikës në rreth, bashki ose komunë apo nga personi i interesuar.

Urdhëri administrativ duhet të dalë jo më vonë se 5 ditë nga dita e informimit.

Kundër urdhërit administrativ mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga nxjerrja e urdhërit të kryetari i bashkisë ose komunës, vendimi i të cilit është i formës së prerë

#### **Neni 65**

Kur në zbatim të nenit 63 dhe 64 të këtij ligji ka kundërshtime, me urdhër të kryetarit të këshillit të rrethit ndërhyjnë forcat e ruajtjes së rendit publik për zbatimin e vendimit. Urdhri për nxjerrjen e shpenzimeve, i firmosur nga kryetari është titull ekzekutiv.

#### **Neni 66**

Prishja e ndërtesave ekzistuese pa leje dënohet me gjobë deri 10000 lekë.

#### **Neni 67**

Gjobat caktohen nga punonjësit e zyrës së urbanistikës në komunë e bashki dhe seksionit të urbanistikës në rreth sipas kompetencave dhe mblidhen nga seksioni i financës në komunë, bashki ose rreth.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, respektivisht tek kryetari i komunës, bashkisë ose kryetari i këshillit të rrethit, vendimi i të cilëve është i formës së prerë.

#### **Neni 68**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes.

Shpallur me dekretin nr. 512, datë 16.4.1993, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.

**Shënim:** Në Ligjin nr. 8015, datë 19.10.1995, jepet edhe ky nen, por nuk përcaktohet nëse duhet të shtohet, apo të ndryshohet ndonjë nen ekzistues

Dokumenti për ngurtësimin e vlerës prej 15 për qind të fondit të ndërtimit kërkohet kur paraqitet kërkesa për leje ndërtimi sipas formularit nr.3 bashkëngjitur ligjit nr.7693, datë

26.4.1995 "Për urbanistikën". Ky fond zhblokohet me paraqitjen e dokumentit për fillimin e punimeve të ndërtimit.

Ky dokument nuk do të kërkohet në rastet kur veprohet me fonde publike (nga shteti)

## Formulari nr.1

### KERKESE PER SHESHE NDERTIMI

Zyrës së Urbanistikës në Bashkinë e \_\_\_\_\_

Zyrës së Urbanistikës në Komunën e \_\_\_\_\_

1. Emri Mbiemri/Emërtimi \_\_\_\_\_

2. Adresa \_\_\_\_\_

3. Shtetësia \_\_\_\_\_

4. Data e dorëzimit të kërkesës \_\_\_\_\_

5. Adresa e sheshit që kërkohet \_\_\_\_\_

6. Sipërfaqja e sheshit (m<sup>2</sup>/ha) \_\_\_\_\_

7. Sheshi kufizohet nga veriu \_\_\_\_\_

jugu \_\_\_\_\_

lindja \_\_\_\_\_

perëndimi \_\_\_\_\_

8. Sheshi kërkohet për ndërtimin e objektit \_\_\_\_\_

me volum të përafërt (m<sup>3</sup>) \_\_\_\_\_

me sipërfaqe ndërtimi (m<sup>2</sup>) \_\_\_\_\_

me lartësi kryesore (m) \_\_\_\_\_

me numër katesh \_\_\_\_\_

me vleftë të përafërt (lekë/dollarë) \_\_\_\_\_

**BASHKELIDHUR KERKESES DUHET TE DOREZOHEN EDHE KETO DOKUMENTE:**

1. Dokument kadastral/ipotekar për pronësinë e sheshit

2. Dokument bankar për ngurtësimin e 15% të vleftës së përafërt të objektit

**KERKUESI**

(Emri Mbiemri)

Emërtimi/Vula

Mendimi i zyrës së urbanistikës \_\_\_\_\_

**Formular nr.2**

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Rrethi \_\_\_\_\_

Bashkia \_\_\_\_\_

Komuna \_\_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

**VENDIM PER DHENIE SHESHI NDERTIMI**

Me vendim të KRRT të Rrethit/Këshillit Bashkisë/Këshillit të Komunës \_\_\_\_\_ , nr. \_\_\_\_\_ , dt. \_\_\_\_\_ , në bazë të kërkesës suaj të datës \_\_\_\_\_ , ju jepet sheshi i ndërtimit me sipërfaqe \_\_\_\_\_ m2 në pozicionin kadastral që kufizohet nga :

veriu \_\_\_\_\_

jugu \_\_\_\_\_

lindja \_\_\_\_\_

perëndimi \_\_\_\_\_

sipas planimetrisë bashkëngjitur( në shkallën1:500/1:1000/1:2000) pjesë e këtij dokumenti.

Projekti i objektit që do të ndërtohet do të respektojë këto kondicione urbanistike-arkitektonike:

- vija e ndërtimit në m \_\_\_\_\_

- koefiçienti i shfrytëzimit të territorit \_\_\_\_\_

- numri dhe funksioni i kateve mbi tokë \_\_\_\_\_

- numri dhe funksioni i kateve nën tokë \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

- lloji i mbulesës \_\_\_\_\_

- lartësia e katit tip \_\_\_\_\_

- hyrja kryesore \_\_\_\_\_

- hyrjet e shërbimit \_\_\_\_\_

- kondicione të veçanta \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Kërkesa për leje ndërtimi duhet të paraqitet brenda datës \_\_\_\_\_ në të kundërt vendimi për dhënien e sheshit anulohet.

**KRYETARI I KESHILLIT**  
**TE RRETHIT/BASHKISE/KOMUNES**

### **Formulari nr.3**

#### **KERKESE PER LEJE NDERTIMI**

Zyrës së Urbanistikës në Bashkinë e \_\_\_\_\_

Zyrës së Urbanistikës në Komunën e \_\_\_\_\_

1. Emri Mbiemri/Emërtimi \_\_\_\_\_

2. Adresa \_\_\_\_\_

3. Shtetësia \_\_\_\_\_

4. Data e dorëzimit të kërkesës \_\_\_\_\_

5. Nr. dhe data e vendimit për marrjen e sheshit të ndërtimit ose dokumenti që vërteton pronësinë mbi sheshin \_\_\_\_\_

6. Projekti është hartuar nga \_\_\_\_\_

( Emërtimi i subjektit, nr. dhe data e licensës )

7. Objekti do të zbatohet nga \_\_\_\_\_

( Emërtimi i subjektit, nr. dhe data e licensës )

8. Miratimi për lidhjen me ujë \_\_\_\_\_

9. Miratim për lidhjen me energji elektrike \_\_\_\_\_

10. Miratim për lidhjen me kanalizim \_\_\_\_\_

11. Miratim për lidhjen me telefoni \_\_\_\_\_

12. Miratim për mbrojtjen nga zjarri \_\_\_\_\_

13. Miratim për mbrojtjen e mjedisit \_\_\_\_\_

13.1 Miratimi nga organet e Inspektoratit Sanitar Shtetëror".

14. Dokumente të veçanta \_\_\_\_\_

**BASHKELIDHUR KERKESES DUHET TE DOREZOHEN EDHE KETO DOKUMENTE:**

1. Plani i organizimit të zbatimit të punimeve

2. Kopje e projektzbatimit të objektit

**K E R K U E S I**

( Emri Mbiemri )

Emërtimi/Vula  
Mendimi i zyrës së urbanistikës

---

---

**Formular nr.4**

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Rrethi \_\_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

**LEJE NDERTIMI**

Me vendim të KRRT të Rrethit \_\_\_\_\_, nr. \_\_\_\_\_, date \_\_\_\_\_ vendimit të KRRT të Rrethit/Këshillit të Bashkisë/Komunës \_\_\_\_\_ nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ për dhënien e sheshit të ndërtimit dhe në bazë të kërkesës suaj të datës \_\_\_\_\_, ju jepet leja e ndërtimit për objektin \_\_\_\_\_

---

Leja i jepet \_\_\_\_\_

(Emërtimi i subjektit që zbaton punimet, nr. dhe data e licensës)

Objekti financohet nga \_\_\_\_\_

( Emërtimi/emri mbiemri i financuesit)

Piketimi i objektit do të bëhet nga \_\_\_\_\_

---

Përfundimi i themeleve u kontrollua nga \_\_\_\_\_

---

Përfundimi i karabinasë u kontrollua nga \_\_\_\_\_

---

**KRYETARI I KESHILLIT TE RRETHIT**

Mora dijëni dhe angazhimin të zbatoj të gjitha dispozitat e përcaktuara me ligj.

( Emri Mbiemri )

Emërtimi/Vula

**Formular nr.5**

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Rrethi \_\_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

**LEJE PER NDERTIME TE PERKOHESHME**

Me vendim të KRRT të Rrethit \_\_\_\_\_, nr. \_\_\_\_\_, date \_\_\_\_\_, vendimit të KRRT të Rrethit/Këshillit të Bashkisë/Komunës

\_\_\_\_\_ nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ për dhënien e sheshit

të ndërtimit, dhe në bazë të kërkesës suaj, të datës \_\_\_\_\_, ju

jepet leja për ndërtim të përkohshëm për objektin

---

Leja i jepet \_\_\_\_\_

( Emërtimi/Emri Mbiemri i kërkesit të lejes)

Afati i lejes \_\_\_\_\_

**KRYETARI I KESHILLIT TE RRETHIT**

Mora dijeni dhe angazhohem të zbatoj të gjitha dispozitat e parashikuara me ligj.

( Emri Mbiemri)

Emërtimi/Vula

**Formular nr.6**

**KERKESE PER PRERJE DRURESH**

Zyrës së Urbanistikës në Bashkinë e \_\_\_\_\_

Zyrës së Urbanistikës në Komunën e \_\_\_\_\_

1. Emri Mbiemri/Emërtimi \_\_\_\_\_

2. Adresa \_\_\_\_\_

3. Shtetësia \_\_\_\_\_

4. Data e dorëzimit të kërkesës \_\_\_\_\_

5. Pozicioni kadastral i zonës ku bëhet prerja e drurëve nga:

veriu \_\_\_\_\_

jugu \_\_\_\_\_

lindja \_\_\_\_\_

perëndimi \_\_\_\_\_

6. Numri i drurëve që do të priten \_\_\_\_\_

7. Lloji i drurëve \_\_\_\_\_

8. Moshja e drurëve \_\_\_\_\_

9. Gjendja biologjike e drurëve \_\_\_\_\_

10. Lartësia e drurëve \_\_\_\_\_

11. Pronësia e drurëve \_\_\_\_\_

**BASHKELIDHUR KERKESES DUHET TE DOREZOHEN EDHE KETO**

**DOKUMENTE:**

1. Projekt sistemimin dhe gjelbërimin e zonës hartuar nga organe të specializuara.

**K E R K U E S I**

( Emri Mbiemri)

Emërtimi/Vula

Mendimi i zyrës së urbanistikës

---

**Formular nr.7**

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Rrethi \_\_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

**LEJE PER PRERJE DRURESH**

Me vendim të KRRT të rrethit \_\_\_\_\_, nr. \_\_\_\_\_, date \_\_\_\_\_ në bazë të kërkesës suaj të datës \_\_\_\_\_ ju jepet leja për prerje drurësh në zonën e kufizuar nga:

veriu \_\_\_\_\_

jugu \_\_\_\_\_

lindja \_\_\_\_\_

perëndimi \_\_\_\_\_

Numri i drurëve që do të priten \_\_\_\_\_

Leja i jepet \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
(Emërtimi/Emri Mbiemri i kërkuarit të lejes )

Afati i lejes \_\_\_\_\_

Shuma e dëmshpërblimit \_\_\_\_\_

**KRYETARI I KESHILLIT TE RRETHIT**

Mora dijeni dhe angazhohem të zbatoj të gjitha dispozitat e parashikuara me ligj.

( Emri Mbiemri )

Emërtimi/Vula



**Formular nr.8**

**KERKESE PER PRISHJE NDERTESE**

Zyrës së Urbanistikës në Bashkinë e \_\_\_\_\_

Zyrës së Urbanistikës në Komunën e \_\_\_\_\_

1. Emri Mbiemri/ Emërtimi \_\_\_\_\_

2. Adresa \_\_\_\_\_

3. Shtetësia \_\_\_\_\_

4. Data e dorëzimit të kërkesës \_\_\_\_\_

5. Ndërtesa kufizohet nga veriu \_\_\_\_\_

jugu \_\_\_\_\_

lindja \_\_\_\_\_

perëndimi \_\_\_\_\_

6. Arsyeja përse kërkohet prishja \_\_\_\_\_

7. Pronari i ndërtesës \_\_\_\_\_

**BASHKELIDHUR KERKESES DUHET TE DOREZOHEN EDHE KETO  
DOKUMENTE:**

1. Dokumenti ipotekar mbi pronësinë e ndërtesës

2. Planimetri dhe pamje e ndërtesës

**K E R K U E S I**

( Emri Mbiemri )

Emërtimi/Vula

Mendimi i zyrës së urbanistikës

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**Formular nr.9**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

Rrethi \_\_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

**LEJE PER PRISHJE NDERTESE**

Me vendim të KRRT të Rrethit \_\_\_\_\_, nr.\_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ në bazë të  
kërkesës suaj të datës \_\_\_\_\_, ju jepet leja për të prishur ndërtesën e kufizuar nga:

veriu \_\_\_\_\_

jugu \_\_\_\_\_

lindja \_\_\_\_\_

perëndimi \_\_\_\_\_

Leja i jepet \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
( Emërtimi/Emri Mbiemri i kërkuesit)

Kondicione që duhen zbatuar gjatë prishjes \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**KRYETARI I KESHILLIT TE RRETHIT**

Mora dijeni dhe angazhohem të zbatoj të gjitha dispozitat e parashikuara me ligj.

( Emri Mbiemri )

Emërtimi/Vula